



NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE DHE MONITORIMIT

Nr. ____ Prot.

Datë. ____/____/2026

Raporti teknik

Objekti : Shërbimi i Pastrimit Bashkia Shkoder Zona Lindore
Burimi i financimit : Buxheti i Bashkise miratuar me VKB Nr. 84 Prot. date 18.12.2025, i ndryshuar
Afati i realizimit : 36 muaj
Fondi preventivuar : **158,878,772.7** lekë me tvsh
Vendodhja : **Zona Lindore, Bashkia Shkodër**

Gjendja aktuale

Aktualisht shërbimi i pastrimit në zonën Lindore realizohet në 98% të territorit, me sipërmarrës privat me një kontratë 3- vjecare që përfundon me 18 Dhjetor 2026. Nisur nga rritja e numrit të turistëve dhe pastrimit të Hot-Spoteve, sasia e tonazhit të parashikuar është drejt ezaurimit para kohe gjë që afron edhe më shumë përfundimin e kontratës aktuale. Shërbimi i pastrimit të zonës Lindore është realizuar në dy menyra: shërbimi në zonën 1 për gjitha NjA me konteniere publik, dhe Zona 2, shërbimi i pastrimit për NjA Shalë, konkretisht fshatin turistik të Thethit.

Zerat e shërbimit konsistojnë në:

- Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve me konteniere;
- Menaxhim dhe Mirembajtje kazanesh;
- Dezinfektimi i pgm've;
- Mirëmbajtje e PGM-ve;

Objektivi

Për zonën Lindore, është menduar që përveç përcaktimeve të parashikuara në kontratën aktuale, të bëhen edhe disa ndryshime dhe shtesa në ofrimin e shërbimit konkretisht:

Nisur nga ngarkesa dhe imazhi jo i mirë përgjatë rrugës nacionale, është parashikuar që evadimi të realizohet çdo ditë e ndërsa për zonat e tjera të NjA Rrethina të realizohet evadim 5 (pesë) herë në javë. Për NjA Postribë dhe Gur i Zi është parashikuar të shtohet dhe një frekuencë tjetër në javë duke qënë se frekuenca aktuale me 3 herë në javë nuk është e mjaftueshme për të realizuar një shërbim pastrimi sa më cilësor. Së fundi problematike ka qënë NjA Shalë ku me kontratën aktuale është realizuar evadim në zonën e Thethit vetëm dy herë në javë për periudhën Prill – Nëntor dhe për periudhën tjetër të vitit nuk është realizuar shërbim pastrimi nisur nga moti i paqëndrueshëm dhe bllokimi i rrugës. Lumi i Shalës nuk ka qënë pjesë e shërbimit duke qënë se periudhën kur janë hartuar specifikimet teknike nuk ka patur hovin e turizmit dhe ka qënë i pamundur aksesimi në zonë. Për kontratën e re është parashikuar që në zonën e Thethit, shërbimi i pastrimit gjatë periudhës Dhjetor – Mars do të kryhet 1 (një) herë në javë, ndërsa gjatë periudhës Prill – Nëntor do të kryhet 3 (tre) herë në javë. Ndërsa në zonën Lumi i Shalës, shërbimi i pastrimit do të realizohet 1 (një) herë në javë.